



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2790/ 6 prot

Datë 14.12.2023

V E N D I M
Nr. 1309/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.12.2023 me:

- Objekt:** Anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-78374-08-28-2023, me objekt “*Ndërtimi i linjës 20kV ajrore N.St Palasë-Tuneli Llogarasë*”, me fond limit 56,077,199 (*pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.11.2023, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale OSSH Vlorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Gjiguria*” SHPK me NIPT J62903456H, me adresë: rruga “*Faik Konica*”, rezidenca “*Lion Park*”, Kt. 3, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria Rajonale OSSH Vlorë.
Adresa: Lagjia “*Kushtrimi*”, Rruga “*Gjergj Kastrioti*”, pranë ish-Frigoriferit, Vlorë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin*”

e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Gjiguria” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17-10-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78374-08-28-2023, me objekt “Ndërtimi i linjës 20kV ajrore N.St Palasë-Tuneli Llogarasë”, me fond limit 56,077,199 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.11.2023, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale OSSH Vlorë.

II.2. Në datën 10.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3592 dhe me nr. 2790/2023 protokollin, datë 13.11.2023 i operatorit ekonomik “Gjiguria” SHPK mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

Ne date 17.10.2023 eshte publikuar ne sistem procedura e prokurimit publik, me objekt “Ndertim i linjes ajrore 20K v N/St Palase-Tuneli Liogarase”, e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale e OS5H Vlore, me date te fundit per pranimin e ofertave daten

06.11.2023 ora 12:00, te parashikuar ne DST, ne sistemin e APP-se dhe ne Buletinin Nr. 87, date 23.10.2023, i publikuar ne faqen e APP-se. Pasi u njohem me Dokumentat Standarte te procedures se mesiperime, ne si Operator Ekonomik filluam me pergatitjen e dokumentacionit ne perputhje me kerkesat e DST-se. Me date 06.11.2023, ne oren 09:00, operatori ekonomik "Gjiguria" sh.p.k do te ngarkonte ne sistem edhe dokumentin e ofertes ekonomike, i cili ishte i vetmi dokument qe na kishte mbetur pa ngarkuar. Sapo hapem procedure ne fjale, u ndeshm me faktin qe nuk ngarkonim dot dokumentin e permendur me siper, pasi rezultonte qe procedura ishte e mbyllur per pranim ofertash edhe pse si afat perfundimtar kjo procedure kishte oren 12:00, te percaktuar ne DST, ne Njoftimin e Shkurtuar te kontrates, ne Buletinin nr. 87, date 23/10/2023 si dhe ne sistemin e APP-se (kjo gje e vertetuar nga ana jone me provat bashkelidhur kesaj ankese), te cilat vertetojne mjaft qarte faktin qe procedura e mesiperme e prokurimit publik eshte mbyllur perpara afatit. Nga sa me siper, ne si operator ekonomik, u penalizuam ne pjesemarrjen ne kete procedure pasi nuk arritem te ngarkonim oferten ekonomike, dokumenti me i rendesishem per pjesemarrjen ne nje procedure prokurimi publik, per shkak te mbylljes se procedures perpara afatit kohor te parashikuar ne DST, i cili ishte ora 12:00. Me poshte po ju rendisim provat dhe faktet te cilat vertetojne mbylljen e procedures perpara afatit te parashikuar ne DST. Ne Njoftimin e shkurtuar te kontrates, Buletinin e Njoftimeve nr. 87, date 23.10.2023 dhe Sistemin e APP-së, qe ishte data 06.11.2023, ora 12:00. DST-ja e procedures me orarin ne oren 12:00. Buletini Nr 87, date 23.10.2023, me orarin 12:00. Me siper, fakti qe verteton se jo vetem ne DST dhe ne Buletin por edhe ne sistemin e APP-se ora e zhviltlimit te procedures ka qene data 06.11.2023, ora 12:00. Njoftimi i shkurtuar i kontrates, i publikuar ne sistemin e APP-se, perseri me oren 12:00. Deri ne oren 11:45, sic edhe verehet kemi mbajtur ne vezhgim sistemin, me qellim mos behej ndonje rregullim dhe hapej procedura perseri, por jo nuk ndodhi. Sa me siper, vertetohet qe procedura eshte mbyllur dhe se nuk mund te ngarkonim dokumenta te tjera vec atyre qe jane ngarkuar, edhe pse ora ka qene 11:13. Nisur nga sa me siper, hapi i pare qe ndermore, ishte komunikimi ne telefon, disa here, ne numrin e percaktuar ne DST, me porsonin pergjegjes te AK, Drejtorise Rajonale te OSSH Vlore, Znj A. D, e cila pasi u vu në dijeni te situates na tha shprehimisht se "kishte ndodhur nje gabim, lapsus nga ana e institucionit, AK ne kete rast, i cili kishte shenuar gabim oren e mbylljes se procedure e cila ne fakt nuk ishte 12:00 por 00:00 dhe se nuk mund te behej asgje per kete" (bashkelidhur do te gjeni komunikimet ne telefon me Znj, A. D). Menjehere beme nje Kerkese, me emertimin "Sqarim", ne sistemin e APP-se, per ti vene si Autoritetin Kontraktor ashtu edhe APP-ne, ne dijeni per situaten, Konkretisht kerkesa eshte bere ne oren 09:36 (bashkelidhur fakti), pra perpara mbylljes së orarit zyrtar te tenderit, percaktuar ne DST. Kerkesen e gjeni bashkelidhur. Si verehet edhe me siper, skemi marre asnje pergjigje nga AK, Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore, edhe pse kerkesa eshte depozituar me perpara orarit te mbylljes se procedures. Menjehere pas kesaj, jemi drejtuar me shkrese zyrtare, nisur me e-mail, me subjekt "Kerkese Urgjente", APP-se si dhe Drejtorise Rajonale te OSSH Vlore. (bashkelidhur e-maili). Nga APP, na eshte kthyer pergjigje me e-mail si me poshte, sipas te cilit shprehimisht na thuhet se: "Pershendetje, Agjencia e Prokurimit Publik mori ne shqyrtim emailin tuaj dhe persa keni kerkuar ju sqarojme se, Sipas verifikimeve te kryera rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor eshte perzgjedhur ora 00:00 e paradites. Krijimi dhe zhvillimi i procedures eshte pergjegjesi e autoritetit kontraktor, Faleminderit !"

Nga sa me siper, shohim qe APP-ja nuk ka mbajtur asnje pergjegjesi te tipit (pezullim ose anullim procedure apo rregullim te lapsusit te ndodhur) ne lidhje me kete lapsus te ndodhur ne sistem, por e ka deleguar kete si pergjegjesi te AK-se, nga i cili nuk kemi marre asnje pergjigje me e-mail, edhe pse eshte vene ne dijeni per problemin jo vetem ne telefon por edhe me e-mail ne adresen (A.D @ossh.al), adrese kjo e publikuar ne DST, si person pergjegjes. Po ashtu eshte e pallogjikshme, mbyllja e nje procedure ne oren 00:00 te mesnates, e cila bie ndesh me orarin zyrtar te punes i cili eshte nga ora 08:00 - 16:30, dhe eshte teresisht e jashteligjshme, pasi nuk ka ndodhur qe nje procedure e zhvilluar nga nje institucion shteteror te mbyllet ne oren 00:00 te mesnates. Pasi kemi tentar perseri, duke nisur disa here e-maile drejt adreses zyrtare te postes elektronike APP-qe, te njejten shkrese te nisur me e-mail, e kemi edhe ne rruge postare, ne te njejten dite, ne date 06.11.2023, institucionit te APP-se si edhe Drejtorise Rajonale të OSSH Vlore dhe ende nuk kemi marre asnje pergjigje (bashkelidhur Fatura postare). Ne date 10.11.2023, kemi marre pergjigje zyrtare, me e-mail nga ana e APP-se ku kete here ka qene nje kthim pergjigje e cila bashkelidhur ka patur nje shkrese zyrtare Nr. 8468/1 Prot., date 11.10.2023 (bashkelidhur shkresa e ardhur me e-mail), email te cilin APP e ka drejtuar edhe te Autoriteti Kontraktor, ku na jepet e drejte per ate cka kemi kerkuar dhe citohet se: “eshte AK, pergjegjes per zhvillimin e nje procedure prokurimi, sipas parashikimeve ligjore dhe nenligjore ne fuqi, duke perfshire ketu hartimin e dokumentave te tenderit, si dhe publikimin e tyre ne SPE” dhe se per proceduren ne fjale, nuk jane zbatuar parimi i trajtimit te barabarte dhe jodiskriminues te cilet jane parime themelore te parashikuara ne Nenin 3/1 te ligjit te LPP-se. Gjithashtu thuhet se shoqeria jone ka te drejten e ankimit prane AK dhe KPP, sipas parashikimeve te Nenit 110 te LPP-se. Nisur nga sa me siper, ju drejtohem ju si organi me i larte per zgjidhjen e ketij problemi, pasi ndihemi te cenuar dhe te diskriminuar nga veprimet e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore. Operator ekonomik “Gjiguria” sh.p.k, nuk eshte trajtuar as ne menyre te barabarte, as ne menyre jo diskriminuese si dhe nuk eshte vepruar me transparence ndaj ketij operatori ekonomik, pasi duket mjaft qarte qe jane favorizuar Operatore te tjere Ekonomik, pjesemarrres ne procedure, pasi eshte shkelur gjeja me kryesore e cila ka te beje me mbylljen e afatit te procedures perpara afatit te deklaruar ne sistem dhe AAP, duke kufizuar keshtu pjesemarrjen ne kete procedure. Nga situatë e mesiperme, ndodhemi perballe faktit qe duke e mbyllur proceduren perpara ores 12:00, te parashikuar ne DST, ne Buletinin Nr. 87, date 23/10/2023 dhe sistemin e APP-se, duke mos lejuar OE “Gjiguria” shpk te, marre pjese ne procedure, verejme se procedura e mesiperme, eshte mbyllur para kohe qellimishit nga ana e AK me qellim ngushtimin e konkurrences artificialisht e cila llogjikisht te con ne arsyetimin e favorizimit te operatoreve te tjere Ekonomik. Nga sa mesiper, Autoriteti Kontraktor eshtë ne shkelje te hapur dhe ne mosrespektim te dispozites se mesiperme, pasi nuk ka respektuar afatin e perfundimit te paraqitjes se ofertave, qe ishte ora 12:00, e parashikuar ne DST, ne Buletinin nr. 87, date 23/10/2023 si dhe sistemin e APP-se (bashkelidhur faktet qe provojne mbylljen e procedures perpara afatit), duke penalizuar keshtu pa te drejte nje Operator Ekonomik, i cili kishte investuar mund dhe shpenzime per pergatitjen e dokumentacionit dhe padrejtesisht eshte trajtuar ne menyre jo te barabarte dhe nuk eshte lejuar per te marre pjese ne proceduren e mesiperme. Nga sa me siper, Autoriteti Kontraktor qe ne momentin qe u vu ne dijeni, se nuk ka respektuar afatin e parashikuar ne DST ne Buletinin nr. 87, dt.

23.10.2023 si dhe sistemin e APP-se, duhet të bente pezullimin dhe anulimin e procedurës për shkak të gabimit të bërë nga ana e tyre në Dokumentat e Tenderit, në të cilat mjaft qartë thuhet se Mbyllja e procedurës është në datën 06.11.2023 ora 12:00. Edhe në rast se i qendrojmë faktit se AK, ka gabuar në vendosjen e orës në DST, si na u tha në bisedën telefonike, nuk e kuptojmë pse duhet të penalizohet Operatori Ekonomik “Gjiguria” shpk për këtë pikë kur shumë mire, nga ana e Autoritetit Kontraktor mund të bëjë anulimi i kësaj procedure si dhe rihedhja perseri në sistem me rregullimin e gabimit të orarit. Rjedhimisht, arrijmë në konkluzionin se kjo ndodhi, e habitëshme dhe e paprecedente, është bërë me qëllim ngushtimin e konkurrencës dhe favorizimin e një Operatori Ekonomik të caktuar nga të dyja këto institucione, si nga APP ashtu edhe nga Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore, të cilat janë përgjegjëse për Dokumentat Standarte të tenderit të publikuara në sistem, nuk është mbajtur asnjë përgjegjësi, por në fund është penalizuar Operatori Ekonomik, i cili nuk ka arritur të hyjë në një procedurë prokurimi publik duke u diskriminuar, trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe jo transparente. Për sa citohet në Nenin 110, thuhet vetëm se OE të cilat janë demtuar nga veprimet e AK, kanë të drejtë të paraqesin ankese, por për rastin tone konkret, nuk parashikohen afate. Afate parashikohen vetëm në rastet kur OE, ka paraqitur Oferte Ekonomike (afati 7 ditor pas publikimit të Njoftimit të fituesit paraprak). Në rastin konkret OE “Gjiguria” shpk, është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe jo të barabartë pasi nuk ka arritur të paraqesë ofertë dhe në të tilla rrethana po ju drejtohem me këtë ankese, duke mos patur një afat të përcaktuar në ligj për bërje ankese dhe duke qenë se shkelja e bërë nga AK Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore, ka qenë flagrante nuk është e nevojshme paraqitje e Mandat pageses në këtë rast, pasi është një rast që as ligji nuk e parashikon. Nga sa më sipër, Operatori ekonomik “Gjiguria” sh.p.k, i cili ka patar interes dhe është angazhuar në përgatitjen e dokumentacionit për procedurën në fjalë, si dhe është demtuar nga veprimet dhe mosveprimet e AK, të cilat janë në kundërshtim të plote me ligjin, i drejtohet me anë të kësaj ankese si AK: Drejtoria Rajonale & OSSH Vlore ashtu edhe KPP-se, duke kërkuar:

I. Anulimin e procedurës së mësipërme, pasi është zhvilluar në kundërshtim të plote me ligjin e LPP-se Nr. 16/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër referencë, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2790/2 prot., datë 14.11.2023 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Gjiguria” SHPK, që kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3592 dhe me nr. 2790/2023 prot., datë 13.11.2023.

II.4. Me shkresën nr. 1851/1 prot, datë 16.11.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2790/3 prot., datë 17.11.2023 me objekt “Kthim përgjigje për ankesën me Nr. A/2023/3592”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Gjiguria” SHPK, ku ka vendosur mos pranimin e ankesës si më poshtë vijonë:

Ankesa është protokolluar nga KPP ne date 13.11.2023, është percjellur prane Autoritetit Kontraktor ne date 13.11.2023, ankesa ka pasur statusin e pa-paguar deri ne daten 15.11.2023. Ne kete date është bere dhe pagesa e mandatit nga ana e OE Ankimues, duke sjellur rrjedhimisht dhe shqyrtimin e saj.

Më datë 17.10.2023, Autoriteti Kontraktor OSSH Njesia Vlore (më poshtë referuar si OSSH Vlore), ka publikuar në SPE/Agjencia e Prokurimit Publik, Njoftimin e Kontrates se Shpallur me objekt “Ndertimi i linjes ajrore 20Kv N/St Palase-Tuneli Llogarase”. Nëdate 06.11.2023, është hapur procedura e prokurimit. Momentalisht Procedura e Prokurimit është ne fazen e vleresimit dhe nuk është vleresuar akoma nga anetaret e komisionit te vleresimit dhe si rrjedhoje nuk ka asnje vendimarrje ne kete drejtim. Ne daten 10.11.2023 është rregjistruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik ankesa e Operatorit Ekonomik “Gjikuria” sh.p.k, e cila rrezulton e protokolluar nga ana e KPP ne daten 13.11.2023. Bazuar nënenin 110, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 97, pika (b) të VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, ankesa u shqyrtua dhe u konkludua se afati i ankimit per ankesen A/2023/3592, datë10.11.2023, ka kaluar. Arsyetimi i detajuar vijon si me poshte: Sipas parashikimeve ligjore bazuar ne Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, seksioni anukimi administrativ, parashikohet ankimim per DST te tenderit dhe ankimim per vendimin e vleresimit te KVO. Duke vere re se nje vendim vlersimi akoma nuk është marre nga anetaret e KVO si dhe duke vene re se OE Ankimues nuk figuron te kete marre pjese ne kete procedure prokurimi (Nuk ka anje insert ne portalin e prokurimeve) dhe per pasoje nuk ka ndonje interes legjitim per pjesen e vleresimit, si dhe duke u bazuar ne ankesen e OE Ankimues i cili pretendon se mangesia qe ka sjellur kete ankimim gjendet ne DST, u konkludua se kjo është nje ankese per DST. Bazuar në nenin 110, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 97, pika (b) të VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, afati per ankimim per DST te tenderit është 7 dite per procedurat nen kufirin e ulet monetar pune. Me konkretisht procedura është publikuar ne date 17.10.2023, ora 00.00 dhe afati i ankimit per DST ka perfunduar me date 24.10.2023. Njekohehisht vihet re se sipas dispozitave te Nenin 75 te ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, cdo OE ka te drejte te kerkoj sqarimi per DST nga AK, me kusht qe kerkesa te jete marre jo me vone se 6 dite para afatit perfundimtar te dorezimit te ofertave. Sipas verifikimeve te bera ne sistemin elektronik OE Ankimues nuk ka kerkuar asnje sqarim ne sistem sipas ketij afati, sqarimet e kerkuara jane pas dates dhe ores perfundimtare te dorezimit te ofertave. Sipas parashikimeve ligjore ne Nenin 40, te ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 42, pika 5 e te njejtit parashikon “Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartëmonetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtrohet me 5 dite “ nga ana e Njesise se Prokurimit, nuk është shfrytëzuar e drejta qe i jep ligji per shkurtimin e procedures me 5 dite ne rast se kryhet ne menyre elektronike, por afati per kete procedure ka qene 21 dite e hapur ne sistem per pranimin e ofertave nga OE. Ne kuptimin e legjislacionit kjo procedure ka respektuar te gjitha afatet ligjore minimale, madje ne tejkalim te kohes qe nje procedure e ketij lloji duhet te rri e hapur ne sistem duke i dhene mundesi kohore OE te pergatisin dhe dorezojne ofertat e tyre ne menyre te barabarte. Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, per cdo procedure

parashikon shkurtim te afateve ligjore kur procedura e prokurimit kryhet me mjete elektronike, pasi eshte menduar qe nje procedure e kryer me mjete elektronike eshte me e aksesueshme per OE pjesmarres, te cilet mund ta marrin informacionin ne kohe reale, mund te kryejne nje aplikim te thjeshtuar ne sistem dhe kane gjithë suportin e nevojshem elektronik qe ofron ky sistem. Pavarsisht ketyre OE Ankimues, edhe pse ka pasur ne dispozicion me mjete elektronike 21 dite kohe per paragitjen e ofertave se tij, nuk e ka shfrytëzuar kete kohe. Sipas verifikimeve te kryer nga APP dhe AKSHI, bazuar dhe ne kthim pergjigjen me Nr. Prot 2468/1, date 10.11.2025 e APP, eshte konstatuar se gjate gjithë kohes afati perfundimtar per pranimin e ofertave ka qene data 06.11.2023 ora 00.00 ne sistem dhe se kjo nuk ka ndryshuar ne asnje moment, cfare deshmon qe nga AK nuk ka pasur asnje ndryshim ne sistem dhe se procedura eshte hedhur dhe publikuar me te njejtat data dhe ore qe kane figuruar te publikuara ne sistem nga dita e publikimit deri ditën e mbylles se afatit të pranimit te ofertave. Per te qene korrekt me OE Ankimues, AK i ka dhene pergjigjen si me poshte te gjitha pretendimeve per shkelje ligjore te ngritura. Kjo shkelje e pretenduar nuk qendron pasi afati prej 21 ditësh ka qene ne dispozicion ne menyre te barabarte per te gjithë OE qe kane pasur dëshire te merrnin pjese ne kete procedure prokurimi. Ne kete procedure prokurimi kane marre pjese 7 OE qe jane pjese e procesit te vleresimit. AK ka pergjegjesi ligjore per keta 7 OE te cilet jane tashme pjese e procesit të vleresimit, te cilet e kane kuptuar sakte publikimin dhe te cilet kane paraqitur ofertat e tyre. Kjo shkelje e pretenduar nuk qendron pasi afati prej 21 ditësh qe ka qene ne dispozicion të OE ne menyre te barabarte, u ka lejuar te martin pjese 7 OE te cilet kane ngarkuar dokumenta ne sistem. Kjo tregon jo vetem qe konkurenca nuk eshte ngushtuar por qe ka pasur nje pjesmarrje te kenaqshme ne sistem qe garanton konkurrencen e OE. Nuk ka pasur asnje shkelje te Neni 90 pika 1 dhe 4 e LPP-se pasi procedura eshte zhvilluar me mjete elektronike dhe procedura eshte mbyllur per te gjithë pjesmarresit ne menyre te barabarte ne date 06.11.2023 ora 00.00 nga ku 7 OE kane pasur mundesine te marrin pjese ne procedure. Procedura eshte zhvilluar teresisht ne perputhje me kerkesat e Manualit per Prokurimin Elektronik, LPP dhe VKM. Afati kohor per dorezimin e ofertave qe kryhen ne menyre elektronike ka qene i pandryshuar, ka respektuar afatet kohore minimale ligjore dhe u ka dhene mundesine 7 OE te jene pjesmarres ne procedure. Mos perputhja midis afatit te pranimit te ofertave ne DST dhe sistemit elektronik prej 12 oresh ka qene objekt ankimi ose objekt per te kerkuar sqarime sipas parshikimeve ligjore per Dokumentat e Tenderit, afatet e te cilave OE Ankimues nuk i ka respektuar. Autoriteti Kontraktor nuk e konsideron se DST te kene mangesi te rendesishme, pasi afatet kohe qe Procedura e Prokurimit ka qene e hapër ne sistem per pranimin e ofertave ka qene ne tejkalim prej 6 ditësh nga afatet minimale qe percakton ligji. Me konkretisht ligji per prokurimin publik qe zhvillohet me mjete elektronike per kete procedure prokurimi parashikon qe ajo te jete e hapur ne sistem per pranimin e ofertave per 15 dite kalendarike ndersa kjo procedure ne sistem ka qene e hapur per pranimin e ofertave per nje afat kohore prej 21 ditësh cfare u ka dhene mundesi 7 OE te paraqesin ofertat e tyre. AK nuk mund ta anuloi kete procedure prokurimi, duke penalizuar ligjerisht 7 OE pjesmarres qe kane paraqitur ofertat e tyre ne afat. AK ne kete procedure prokurimi ka perdorur DST, te cilat kane qene te disponueshme on-line per te gjithë OE ne menyre te barabarte dhe transparente. Per sa me siper pretendimi i OE nuk qendron, pasi ankesa e paraqitur per DST eshte jashte afatit te parashikuar ne nenin 110 pika 1 te ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin Publik" dhe

ne nenin 97, pika b të VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar. Ne perfundim pergjithcka sa trajtova me lart pretendimet e operatorit ekonomik "Gjiguria" shpk nuk qendrojne.

II.5. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Gjiguria" SHPK mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt – shqyrtimi, se "Autoriteti Kontraktor është ne shkelje te hapur dhe ne mosrespektim te dispozites se mesiperme, pasi nuk ka respektuar afatin e perfundimit te paraqitjes se ofertave, qe ishte ora 12:00, e parashikuar ne DST, ne Buletinin nr. 87, date 23/10/2023 si dhe sistemin e APP-se (bashkelidhur faktet qe provojne mbylljen e procedures perpara afatit), duke penalizuar keshtu pa te drejte nje Operator Ekonomik, i cili kishte investuar mund dhe shpenzime per pergatitjen e dokumentacionit dhe padrejtesisht eshte trajtuar ne menyre jo te barabarte dhe nuk eshte lejuar per te marre pjese ne proceduren e mesiperme. Nga sa me siper, Autoriteti Kontraktor qe ne momentin qe u vu ne dijeni, se nuk ka respektuar afatin e parashikuar ne DST ne Buletinin nr. 87, dt. 23.10.2023 si dhe sistemin e APP-se, duhet të bente pezullimin dhe anulimin e procedures per shkak te gabimit te bere nga ana e tyre ne Dokumentat e Tenderit, ne te cilat mjaft qarte thuhet se Mbyllja e procedures eshte ne daten 06.11.2023 ora 12:00. Edhe ne rast se i qendrojme faktit se AK, ka gabuar ne vendosjen e ores ne DST, si na u tha ne biseden telefonike, nuk e kuptojme pse duhet te penalizohet Operatori Ekononuk "Gjiguria" shpk per kete pike kur shume mire, nga ana e Auntoritetit Kontraktor mund te behej anulimi i kesaj procedure si dhe rihedhja perseri ne sistem me rregullimin e gabimit te orarit", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

II.1.1. Në datën 17-10-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "Procedurë e Hapur", me Nr. REF-78374-08-28-2023, me objekt "Ndërtimi i linjës 20kV ajrore N.St Palasë-Tuneli Llogarasë", me fond limit 56,077,199 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 06.11.2023, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale OSSH Vlorë.

III.1.2. Në datën 10.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3592 dhe me nr. 2790/2023 protokolli, datë 13.11.2023 e operatorit ekonomik

“Gjiguria” SHPK mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

Ne date 17.10.2023 është publikuar ne sistem procedura e prokurimit publik, me objekt “Ndertim i linjes ajrore 20K v N/St Palase-Tuneli Liogarase”, e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Drejtora Rajonale e OS5H Vlore, me date te fundit per pranimin e ofertave daten 06.11.2023 ora 12:00, te parashikuar ne DST, ne sistemin e APP-se dhe ne Buletinin Nr. 87, date 23.10.2023, i publikuar ne fagen e APP-se. Pasi u njohem me Dokumentat Standarte te procedures se mesiperime, ne si Operator Ekonomik filluam me pergatitjen e dokumentacionit ne perputhje me kerkesat e DST-se. Me date 06.11.2023, ne oren 09:00, operatori ekonomik “Gjiguria” sh.p.k do te ngarkonte ne sistem edhe dokumentin e ofertes ekonomike, i cili ishte i vetmi dokument qe na kishte mbetur pa ngarkuar. Sapo hapem procedure ne fjale, u ndeshm me faktin qe nuk ngarkonim dot dokumentin e permendur me siper, pasi rezultonte qe procedura ishte e mbyllur per pranim ofertash edhe pse si afat perfundimtar kjo procedure kishte oren 12:00, te percaktuar ne DST, ne Njoftimin e Shkurtuar te kontrates, ne Buletinin nr. 87, date 23/10/2023 si dhe ne sistemin e APP-se (kjo gje e vertetuar nga ana jone me provat bashkelidhur kesaj ankese), te cilat vertetojne mjaft qarte faktin qe procedura e mesiperme e prokurimit publik eshte mbyllur perpara afatit. Nga sa me siper, ne si operator ekonomik, u penalizuam ne pjesemarrjen ne kete procedure pasi nuk arritem te ngarkonim oferten ekonomike, dokumenti me i rendesishem per pjesemarrjen ne nje procedure prokurimi publik, per shkak te mbylljes se procedures perpara afatit kohor te parashikuar ne DST, i cili ishte ora 12:00. Me poshte po ju rendisim provat dhe faktet te cilat vertetojne mbylljen e procedures perpara afatit te parashikuar ne DST. Ne Njoftimin e shkurtuar te kontrates, Buletinin e Njoftimeve nr. 87, date 23.10.2023 dhe Sistemin e APP-së, qe ishte data 06.11.2023, ora 12:00. DST-ja e procedures me orarin ne oren 12:00. Buletini Nr 87, date 23.10.2023, me orarin 12:00. Me siper, fakti qe verteton se jo vetem ne DST dhe ne Buletin por edhe ne sistemin e APP-se ora e zhviltlimit te procedures ka qene data 06.11.2023, ora 12:00. Njoftimi i shkurtuar i kontrates, i publikuar ne sistemin e APP-se, perseri me oren 12:00. Deri ne oren 11:45, sic edhe verehet kemi mbajtur ne vezhgim sistemin, me qellim mos behej ndonje rregullim dhe hapej procedura perseri, por jo nuk ndodhi. Sa me siper, vertetohet qe procedura eshte mbyllur dhe se nuk mund te ngarkonim dokumenta te tjera vec atyre qe jane ngarkuar, edhe pse ora ka qene 11:13. Nisur nga sa me siper, hapi i pare qe ndermorem, ishte komunikimi ne telefon, disa here, ne numrin e percaktuar ne DST, me porsonin pergjegjes te AK, Drejtorise Rajonale te OSSH Vlore, Znj A. D, e cila pasi u vu në dijeni te situates na tha shprehimisht se “kishte ndodhur nje gabim, lapsus nga ana e institucionit, AK ne kete rast, i cili kishte shenuar gabim oren e mbylljes se procedure e cila ne fakt nuk ishte 12:00 por 00:00 dhe se nuk mund te behej asgje per kete” (bashkelidhur do te gjeni komunikimet ne telefon me Znj, A. D). Menjehere beme nje Kerkese, me emertimin “Sqarim”, ne sistemin e APP-se, per ti vene si Autoritetin Kontraktor ashtu edhe APP-ne, ne dijeni per situaten, Konkretisht kerkesa eshte bere ne oren 09:36 (bashkelidhur fakti), pra perpara mbylljes së orarit zyrtat te tenderit, percaktuar ne DST. Kerkesen e gjeni bashkelidhur. Si verehet edhe me siper, skemi marre asnje pergjigje nga AK, Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore, edhe pse kerkesa eshte depozituar me perpara orarit te mbylljes se procedures. Menjehere pas kesaj, jemi drejtuar me shkrese zyrtare, nisur me e-

mail, me subjekt “Kerkese Urgjente”, APP-se si dhe Drejtorise Rajonale te OSSH Vlore. (bashkelidhur e-maili). Nga APP, na eshte kthyer pergjigje me e-mail si me poshte, sipas te cilit shprehimisht na thuhet se: “Pershendetje, Agjencia e Prokurimit Publik mori ne shqyrtim emailin tuaj dhe persa keni kerkuar ju sqarojme se, Sipas verifikimeve te kryera rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor eshte perzgjedhur ora 00:00 e paradites. Krijimi dhe zhvillimi i procedures eshte pergjegjesi e autoritetit kontraktor, Faleminderit !”

Nga sa me siper, shohim qe APP-ja nuk ka mbajtur asnje pergjegjesi te tipit (pezullim ose anullim procedure apo rregullim te lapsusit te ndodhur) ne lidhje me kete lapsus te ndodhur ne sistem, por e ka deleguar kete si pergjegjesi te AK-se, nga i cili nuk kemi marre asnje pergjigje me e-mail, edhe pse eshte vene ne dijeni per problemin jo vetem ne telefon por edhe me e-mail ne adresen (A.D @ossh.al), adrese kjo e publikuar ne DST, si person pergjegjes. Po ashtu eshte e pallogjikshme, mbyllja e nje procedure ne oren 00:00 te mesnates, e cila bie ndesh me orarin zyrtar te punes i cili eshte nga ora 08:00 - 16:30, dhe eshte teresisht e jashteligjshme, pasi nuk ka ndodhur qe nje procedure e zhvilluar nga nje institucion shteteror te mbyllet ne oren 00:00 te mesnates. Pasi kemi tentar perseri, duke nisur disa here e-maile drejt adreses zyrtare te postes elektronike APP-qe, te njejten shkrese te nisur me e-mail, e kemi edhe ne rruge postare, ne te njejten dite, ne date 06.11.2023, institucionit te APP-se si edhe Drejtorise Rajonale të OSSH Vlore dhe ende nuk kemi marre asnje pergjigje (bashkelidhur Fatura postare). Ne date 10.11.2023, kemi mare pergjigje zyrtare, me e-mail nga ana e APP-se ku kete here ka qene nje kthim pergjigje e cila bashkelidhur ka patur nje shkrese zyrtare Nr. 8468/1 Prot., date 11.10.2023 (bashkelidhur shkresa e ardhur me e-mail), email te cilin APP e ka drejtuar edhe te Autoriteti Kontraktor, ku na jepet e drejte per ate cka kemi kerkuar dhe citohet se: “eshte AK, pergjegjes per zhvillimin e nje procedure prokurimi, sipas parashikimeve ligjore dhe nenligjore ne fuqi, duke perfshire ketu hartimin e dokumentave te tenderit, si dhe publikimin e tyre ne SPE” dhe se per proceduren ne fjale, nuk jane zbatuar parimi i trajtimit te barabarte dhe jodiskriminues te cilet jane parime themelore te parashikuara ne Nenin 3/1 te ligjit te LPP-se. Gjithashtu thuhet se shoqeria jone ka te drejten e ankimit prane AK dhe KPP, sipas parashikimeve te Nenit 110 te LPP-se. Nisur nga sa me siper, ju drejtohem ju si organi me i larte per zgjidhjen e ketij problemi, pasi ndihemi te cenuar dhe te diskriminuar nga veprimet e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore. Operator ekonomik “Gjiguria” sh.p.k, nuk eshte trajtuar as ne menyre te barabarte, as ne menyre jo diskriminuese si dhe nuk eshte vepruar me transparence ndaj ketij operatori ekonomik, pasi duket mjaft qarte qe jane favorizuar Operatore te tjere Ekonomik, pjesemarrjes ne procedure, pasi eshte shkelur gjeja me kryesore e cila ka te beje me mbylljen e afatit te procedures perpara afatit te deklaruar ne sistem dhe AAP, duke kufizuar keshtu pjesemarrjen ne kete procedure. Nga situatet e mesiperme, ndodhemi perballe faktit qe duke e mbyllur proceduren perpara ores 12:00, te parashikuar ne DST, ne Buletinin Nr. 87, date 23/10/2023 dhe sistemin e APP-se, duke mos lejuar OE “Gjiguria” shpk te, marre pjese ne procedure, verejme se procedura e mesiperme, eshte mbyllur para kohe qellimishit nga ana e AK me qellim ngushtimin e konkurrences artificialisht e cila llogjikisht te con ne arsyetimin e favorizimit te operatoreve te tjere Ekonomik. Nga sa mesiper, Autoriteti Kontraktor eshte ne shkelje te hapur dhe ne mosrespektim te dispozites se mesiperme, pasi nuk ka respektuar afatin e perfundimit te paraqitjes se ofertave, qe ishte ora 12:00, e parashikuar ne DST, ne

Buletinin nr. 87, date 23/10/2023 si dhe sistemin e APP-se (bashkelidhur faktet qe provojne mbylljen e procedures perpara afatit), duke penalizuar keshtu pa te drejte nje Operator Ekonomik, i cili kishte investuar mund dhe shpenzime per pergatitjen e dokumentacionit dhe padrejtesisht eshte trajtuar ne menyre jo te barabarte dhe nuk eshte lejuar per te marre pjese ne proceduren e mesiperme. Nga sa me siper, Autoriteti Kontraktor qe ne momentin qe u vu ne dijeni, se nuk ka respektuar afatin e parashikuar ne DST ne Buletinin nr. 87, dt. 23.10.2023 si dhe sistemin e APP-se, duhet të bente pezullimin dhe anulimin e procedures per shkak te gabimit te bere nga ana e tyre ne Dokumentat e Tenderit, ne te cilat mjaft qarte thuhet se Mbyllja e procedures eshte ne daten 06.11.2023 ora 12:00. Edhe ne rast se i qendrojme faktit se AK, ka gabuar ne vendosjen e ores ne DST, si na u tha ne biseden telefonike, nuk e kuptojme pse duhet te penalizohet Operatori Ekonomik "Gjiguria" shpk per kete pike kur shume mire, nga ana e Auntoritetit Kontraktor mund te behej anulimi i kesaj procedure si dhe rihedhja perseri ne sistem me rregullimin e gabimit te orarit. Rjedhimisht, arrijm ne konkluzionin se kjo ndodhi, e habiteshme dhe e paprecedente, eshte bere me qellim ngushtimin e konkurrences dhe favorizimin e nje Operator Ekonomik te caktuar nga te dyja keto institucione, si nga APP ashtu edhe nga Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore, te cilat jane pergjegjese per Dokumentat Standarte te tenderit te publikuara ne sistem, nuk eshte mbajtur asnje pergjegjesi, por ne fund eshte penalizuar Operatori Ekonomik, i cili nuk ka arritur te hyje ne nje proceure prokurimi publik duke u diskriminuar, trajtuar ne menyre jo te barabarte dhe jo transparente. Per sa citohet ne Nenin 110, thuhet vetem se OE te cilet jane demtuar nga veprimet e AK, kane te drejte te paraqesin ankese, por per rastin tone konkret, nuk parashikohen afate. Afate parashikohen veten ne rastet kur OE, ka paraqitur Oferte Ekonomike (afati 7 ditor pas publikimit te Njoftimit te fituesit paraparak). Ne rastin konkret OE "Gjiguria" shpk, eshte trajtuar ne menyre diskriminuese dhe jo te barabarte pasi nuk ka arritur te paraqese oferte dhe ne te tilla rrethana po ju drejtohem me kete ankese, duke mos patur nje afat te percaktuar ne ligj per berje ankese dhe duke qene se shkelja e bere nga AK Drejtoria Rajonale e OSSH Vlore, ka qene flagrante nuk eshte e nevojshme paraqitje e Mandat pageses ne kete rast, pasi eshte nje rast qe as ligji nuk e parashikon. Nga sa me siper, Operatori ekonomik "Gjiguria" sh.p.k, i cili ka patar interes dhe eshte angazhuar ne pergatitjen e dokumentacionit per proceduren ne fjale, si dhe eshte demtuar nga veprimet dhe mosveprimet e AK, te cilat jane ne kundërshtim te plote me lgjin, i drejtohet me ane te kesaj ankese si AK: Drejtoria Rajonale & OSSH Vlore ashtu edhe KPP-se, duke kerkuar:

1. Anullimin e procedures se mesiperme, pasi eshte zhvilluar ne kundërshtim te plote me ligjin e LPP-se Nr. 16/2020 "Per Prokurimin Publik" dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

III.1.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2790/2 prot., datë 14.11.2023 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Gjiguria" SHPK, që kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3592 dhe me nr. 2790/2023 prot., datë 13.11.2023.

III.1.4. Me shkresën nr. 1851/1 prot, datë 16.11.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2790/3 prot., datë 17.11.2023 me objekt “Kthim - përgjigje për ankesën me Nr. A/2023/3592”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë “Gjiguria” SHPK, ku ka vendosur mospranimin e ankesës si më poshtë vijon:

Ankesa eshte protokolluar nga KPP ne date 13.11.2023, eshte percjellur prane Autoritetit Kontraktor ne date 13.11.2023, ankesa ka pasur statusin e pa-paguar deri ne daten 15.11.2023. Ne kete date eshte bere dhe pagesa e mandatit nga ana e OE Ankimues, duke sjellur rrjedhimisht dhe shqyrtimin e saj.

Më datë 17.10.2023, Autoriteti Kontraktor OSSH Njesia Vlore (më poshtë referuar si OSSH Vlore), ka publikuar në SPE/Agjencia e Prokurimit Publik, Njoftimin e Kontrates se Shpallur me objekt “Ndertimi i linjes ajrore 20Kv N/St Palase-Tuneli Llogarase”. Nëdate 06.11.2023, eshte hapur procedura e prokurimit. Momentalisht Procedura e Prokurimit eshte ne fazen e vleresimit dhe nuk eshte vleresuar akoma nga anetaret e komisionit te vleresimit dhe si rrjedhoje nuk ka asnje vendimarrje ne kete drejtim. Ne daten 10.11.2023 është rregjistruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik ankesa e Operatorit Ekonomik “Gjiguria” sh.p.k, e cila rrezulton e protokolluar nga ana e KPP ne daten 13.11.2023. Bazuar nënenin 110, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 97, pika (b) të VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, ankesa u shqyrtua dhe u konkludua se afati i ankimimit per ankesen A/2023/3592, datë10.11.2023, ka kaluar. Arsyetimi i detajuar vijon si me poshte: Sipas parashikimeve ligjore bazuar ne Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, seksioni anukimi administrativ, parashikohet ankimim per DST te tenderit dhe ankimim per vendimin e vleresimit te KVO. Duke vere re se nje vendim vlersimi akoma nuk eshte marre nga anetaret e KVO si dhe duke vene re se OE Ankimues nuk figuron te kete marre pjese ne kete procedure prokurimi (Nuk ka anje insert ne portalin e prokurimeve) dhe per pasoje nuk ka ndonje interes legjitim per pjesen e vleresimit, si dhe duke u bazuar ne ankesen e OE Ankimues i cili pretendon se mangesia qe ka sjellur kete ankimim gjendet ne DST, u konkludua se kjo eshte nje ankese per DST. Bazuar në nenin 110, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 97, pika (b) të VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, afati per ankimim per DST te tenderit eshte 7 dite per procedurat nen kufirin e ulet monetar pune. Me konkretisht procedura eshte publikuar ne date 17.10.2023, ora 00.00 dhe afati i ankimimit per DST ka perfunduar me date 24.10.2023. Njekohesisht vihet re se sipas dispozitave te Nenin 75 te ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, cdo OE ka te drejte te kerkoj sqarimi per DST nga AK, me kusht qe kerkesa te jete marre jo me vone se 6 dite para afatit perfundimtar te dorezimit te ofertave. Sipas verifikimeve te bera ne sistemin elektronik OE Ankimues nuk ka kerkuar asnje sqarim ne sistem sipas ketij afati, sqarimet e kerkuara jane pas dates dhe ores perfundimtare te dorezimit te ofertave. Sipas parashikimeve ligjore ne Nenin 40, te ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 42, pika 5 e te njejtit parashikon “Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit tëulët dhe tëlartëmonetar, afati për pranimin e ofertave ështëjo mëpak se 20 ditënga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, nërast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund tëshkurtohet me 5 dite “ nga ana e Njesise se Prokurimit, nuk eshte shfrytezuar

e drejta qe i jep ligji per shkurtrimin e procedures me 5 dite ne rast se kryhet ne menyre elektronike, por afati per kete procedure ka qene 21 dite e hapur ne sistem per pranimin e ofertave nga OE. Ne kuptimin e legjislacionit kjo procedure ka respektuar te gjitha afatet ligjore minimale, madje ne tejkallim te kohes qe nje procedure e ketij lloji duhet te rri e hapur ne sistem duke i dhene mundesi kohore OE te pergatisin dhe dorezojne ofertat e tyre ne menyre te barabarte. Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", per cdo procedure parashikon shkurtrim te afateve ligjore kur procedura e prokurimit kryhet me mjete elektronike, pasi eshte menduar qe nje procedure e kryer me mjete elektronike eshte me e aksesueshme per OE pjesmarres, te cilet mund ta marrin informacionin ne kohe reale, mund te kryejne nje aplikim te thjeshtuar ne sistem dhe kane gjithë suportin e nevojshem elektronik qe ofron ky sistem. Pavarsisht ketyre OE Ankimues, edhe pse ka pasur ne dispozicion me mjete elektronike 21 dite kohe per paragjitjen e ofertave se tij, nuk e ka shfrytëzuar kete kohe. Sipas verifikimeve te kryer nga APP dhe AKSHI, bazuar dhe ne kthim pergjigjen me Nr. Prot 2468/1, date 10.11.2025 e APP, eshte konstatuar se gjate gjithë kohes afati perfundimtar per pranimin e ofertave ka qene data 06.11.2023 ora 00.00 ne sistem dhe se kjo nuk ka ndryshuar ne asnje moment, çfare deshmon qe nga AK nuk ka pasur asnje ndryshim ne sistem dhe se procedura eshte hedhur dhe publikuar me te njejtat data dhe ore qe kane figuruar te publikuara ne sistem nga dita e publikimit deri ditën e mbylles se afatit të pranimit te ofertave. Per te qene korrekt me OE Ankimues, AK i ka dhene pergjigjen si me poshte te gjitha pretendimeve per shkelje ligjore te ngritura. Kjo shkelje e pretenduar nuk qendron pasi afati prej 21 ditesh ka qene ne dispozicion ne menyre te barabarte per te gjithë OE qe kane pasur dëshire te marrin pjese ne kete procedure prokurimi. Ne kete procedure prokurimi kane marre pjese 7 OE qe jane pjese e procesit te vleresimit. AK ka pergjegjesi ligjore per keta 7 OE te cilet jane tashme pjese e procesit të vleresimit, te cilet e kane kuptuar sakte publikimin dhe te cilet kane paraqitur ofertat e tyre. Kjo shkelje e pretenduar nuk qendron pasi afati prej 21 ditesh qe ka qene ne dispozicion të OE ne menyre te barabarte, u ka lejuar te marrin pjese 7 OE te cilet kane ngarkuar dokumenta ne sistem. Kjo tregon jo vetem qe konkurrenca nuk eshte ngushtuar por qe ka pasur nje pjesmarrje te kenaqshme ne sistem qe garanton konkurrencen e OE. Nuk ka pasur asnje shkelje te Neni 90 pika 1 dhe 4 e LPP-se pasi procedura eshte zhvilluar me mjete elektronike dhe procedura eshte mbyllur per te gjithë pjesmarrësit ne menyre te barabarte ne date 06.11.2023 ora 00.00 nga ku 7 OE kane pasur mundesine te marrin pjese ne procedure. Procedura eshte zhvilluar teresisht ne perputhje me kerkesat e Manualit per Prokurimin Elektronik, LPP dhe VKM. Afati kohor per dorezimin e ofertave qe kryhen ne menyre elektronike ka qene i pandryshuar, ka respektuar afatet kohore minimale ligjore dhe u ka dhene mundesine 7 OE te jene pjesmarres ne procedure. Mos perputhja midis afatit te pranimit te ofertave ne DST dhe sistemit elektronik prej 12 oresh ka qene objekt ankimi ose objekt per te kerkuar sqarime sipas parshikimeve ligjore per Dokumentat e Tenderit, afatet e te cilave OE Ankimues nuk i ka respektuar. Autoriteti Kontraktor nuk e konsideron se DST te kene mangesi te rendesishme, pasi afatet kohe qe Procedura e Prokurimit ka qene e hapër ne sistem per pranimin e ofertave ka qene ne tejkallim prej 6 ditesh nga afatet minimale qe percakton ligji. Me konkretisht ligji per prokurimin publik qe zhvillohet me mjete elektronike per kete procedure prokurimi parashikon qe ajo te jete e hapur ne sistem per pranimin e ofertave per 15 dite kalendarike ndersa kjo procedure ne sistem ka qene e hapur per pranimin e ofertave per nje afat kohore

prej 21 ditësh çfarë u ka dhënë mundësi 7 OE të paraqesin ofertat e tyre. AK nuk mund ta anullojë këtë procedurë prokurimi, duke penalizuar ligjërisht 7 OE pjesëmarrës që kanë paraqitur ofertat e tyre në afat. AK në këtë procedurë prokurimi ka përdorur DST, të cilat kanë qenë të disponueshme on-line për të gjithë OE në mënyrë të barabartë dhe transparente. Për sa më sipër pretendimi i OE nuk qëndron, pasi ankesa e paraqitur për DST është jashtë afatit të parashikuar në nenin 110 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe në nenin 97, pika b të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar. Në përfundim përgjithësisht sa trajtova më lart pretendimet e operatorit ekonomik “Gjiguria” shpk nuk qëndrojnë.

III.1.5. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III.1.6. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

III.1.7. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.8. Në nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce.

Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.

Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.

III.1.9. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.**

III.1.10. Në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

III.1.11. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

III.1.12. Neni 115, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës”.

III.1.13. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankesë tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.14. Në nenin 97 “Afatet për paraqitjen e ankesave” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

- a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.
2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:
- a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimit të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimit të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.
3. Në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, në procedurat e prokurimit me faza, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:
- a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.
4. Në rastin e ankesave për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, pas procedurave për rihapjen e konkurrimit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:
- a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

III.1.15. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga **publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit**. Në rastin konkret referuar verifikimeve në sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi, se në datën 17.10.2023 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftimit të Kontratës në sistemin e prokurimeve elektronike, e cila mban si datë hapjeje datën 17.10.2023 ora 00:00 dhe datë mbylljeje datën 06.11.2023 ora 00:00. Nga verifikimi i raportit të auditit, konkretisht seksionit afatet kohore dhe seksionit njoftimet rezultoi, se data e publikimit të procedurës së prokurimit është data 17.10.2023 ora 12:00 AM, dhe data e mbylljes data 06.11.2023 ora 12:00, datë e cila është e përcaktuar edhe në përmbajtjen e dokumenteve standarde të tenderit. Nga sa më sipër rezultoi, se të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar janë vënë në dijeni në lidhje me afatin e mbylljes së procedurës së prokurimit. Rrjedhimisht edhe operatori ekonomik ankimues është njohur me dokumentet standarde të tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës, pra në datën 07.11.2023. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se afatet e ankimimit për dokumentet standarde të tenderit të procedurës objekt-ankimi për ankimuesin, nisin në datën 17.10.2023 dhe mbarojnë në ditën e 7 (shtatë) sipas parashikimit ligjor në nenin 110 pika 1, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Pra operatori ekonomik ankimues, por edhe të gjithë operatorët e tjerë

ekonomikë të interesuar kanë pasur momentin procedural të dorëzimit të ankesës apo të kërimit të sqarimeve në lidhje me mospërputhjen e orarit të mbylljes së procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, brenda periudhës 7 (shtatë) ditore nga publikimi i procedurës ose të kërimit të sqarimeve jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Ndaj KPP gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit Prokurimit Publik më datë 10.11.2023, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike më numër ankimi elektronik A/2023/3592 dhe me nr. 2790/2023 prot, datë 13.11.2023, është jashtë afateve ligjore të ankimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar jo më vonë se në datën 23.10.2023, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik, ose të kërkohej sqarime nga ana e ankimesit jo më vonë se data 01.11.2023, ndërkohë që nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike, rubrikës kërkesa, rezulton se ankimesi ka kërkuar sqarim më datë 06.11.2023.

III.1.16. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110 pika 1 e LPP i cili parashikon, se *Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë*.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe përfundon në ditën e 7 (shtatë). Në rastin konkret data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është 17.10.2023, ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimesi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik mban datën 10.11.2023 me numër ankimi elektronik A/2023/3592 dhe me nr. 2790/2023 prot, datë 13.11.2023, është jashtë afatit 7 (shtatë) ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar kështu *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret vërtetohet, se ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimit.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritet kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të

drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën. Komisioni i Prokurimit Publik riktheson, se ligjvënësi në nenin 118 të LPP dhe në VKM Nr. 486, datë 21.7.2022 “Për Përcaktimin e Rregullave për Pavlefshmërinë e Kontratave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar garanci për operatorët ekonomikë të interesuar në lidhje me veprimet apo vendimet e autoritetit kontraktor, që bien ndesh me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Gjiguria” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-78374-08-28-2023, me objekt “Ndërtimi i linjës 20kV ajrore N.St Palasë-Tuneli Llogarasë”, me fond limit 56,077,199 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.11.2023, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale OSSH Vlorë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Gjiguria” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri